



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 61/2016

Prishtinë, më 16.6.2016, në orën 09:45

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Sabit Gashi e Fazile Bekteshi – MZHE dhe Fjolla Uka - KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Donika Lushaku - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Konfirmimi i Amendamenteve të pakos së projektligjeve të energjisë;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Konfirmimi i Amendamenteve të pakos së projektligjeve të energjisë

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit: E njoftoj Komisionin se në bazë të takimit të dy deputetëve të autorizuar nga Komisioni: Besim Beqaj, kryesues i grupit të punës për projektligjet për energji elektrike dhe projektligjit për gaz natyror, Raif Qela kryesues i grupit të punës për projektligjet për energji dhe projektligjin për rregullatorin e energjisë, dhe Fatmir Rexhpi anëtarë i Komisionit, jemi takuar më përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për t'i diskutuar komentet dhe rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe të aktorëve dhe të partnerëve të tjerë. Andaj, ua prezantoj propozimet si vijon:

Të projektligji për energjinë elektrike, kemi propozim që të **Amendamenti 14, që e shton nenin e ri 13**, ta formulojmë paragrafin 6, si vijon:

Amendamenti 14,

Neni 13

6. Kuvendi i Kosovës mund të nisë procedurën për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit kur, pas 2 (dy) vjetëve të njëpasnjëshme të rishikimit të performancës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Komisioni Funkcional gjen se:

6.1 Operatorit të Sistemit të Transmetimit nuk ka arritur të dëshmojë se plotësisht dhe në mënyrë aktive ka zbatuar funksionet dhe detyrat sipas ligjeve që rregullojnë sektorin e energjisë në Kosovë; dhe

6.2 Dështimi i tillë i zbatimit ka dëmtuar seriozisht funksionimin efikas, efektiv dhe të pavarur të sistemit të operimit të transmisionit.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

Po ashtu të projektligji për energjinë elektrike, jemi pajtuar në takimin e datës 14.6.2016, që në **Amendamentin 14, në nenin e ri 14, nënparagrafi 6.2**, në vend të fjalës “Qeveria” të shënohet “Komisioni parlamentar përkatës për Energji...”, si dhe në të njëjtin Amendament të **nënparagrafi 6.1**, në vend të fjalës “Ministria...” të jetë fjalia “Ministria e Administratës Publike”.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

Të projektligji për rregullatorin e energjisë, kemi propozim që **Amendamenti 17, paragrafi 2**, të riformulohet si vijon:

Amendamenti 17,

Neni 8

2. Anëtarët e Bordit dhe Personeli i Rregullatorit nuk e kanë statusin e shërbyesit civil.

Besim Beqaj: Propozoj që Komisioni ta “fshijë në tërësi pikën 2” sepse më këtë riformulim nuk po rregullohet asgjë. Bordi dhe personeli i tanishëm nuk janë as tani shërbyes civil, mandej edhe me propozim po thuhet nuk janë.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Beqaj.

Të projektligji për rregullatorin e energjisë, kemi propozim që **Amendament 19**, të riformulohet si vijon:

Amendament 19,

Neni 10

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3 me tekstin si vijon:

3. Kuvendi i Kosovës mund të nisë procedurën për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Rregullatorit, kur, pas 2 (dy) vjetëve të njëpasnjëshme të rishikimit të performancës së ZRRE-së , Komisioni Funkcional gjen se:

3.1 Rregullatori nuk ka arritur të dëshmojë se plotësisht dhe në mënyrë aktive ka zbatuar funksionet dhe detyrat sipas ligjeve që rregullojnë sektorin e energjisë në Kosovë; dhe

3.2 Dështimi i tillë të zbatimit ka dëmtuar seriozisht rregullimin efikas, efektiv dhe të pavarur të sektorit të energjisë.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

3. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 10:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa